

L I G J
Nr.8002, datë 27.9.1995

PËR PËRDORIMIN DHE ADMINISTRIMIN E PULLAVE TË TAKSAVE

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Taksa e pullës është një taksë e caktuar për aktet dhe dokumentet që lëshohen në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas listave nr.1 dhe nr.2, që janë pjesë përbërëse e këtij ligji.

Taksa e pullës vilet duke iu vendosur pulla akteve dhe dokumenteve të parashikuara në këtë ligj.

Neni 2

Pullat e taksave janë letra me vlerë, me anën e të cilave vërtetohet pagesa e taksës nga personat fizikë e juridikë, publikë e privatë, vendas e të huaj, për aktet dhe dokumentet e parashikuara në këtë ligj.

Neni 3

Përmasat e pullave të taksave të jenë në kufijtë maksimalë 2.5 milimetra dhe 3.5 milimetra.

Neni 4

Pullat e taksave do të kenë të shtypura fjalët “Republika e Shqipërisë”, “Pullë takse” dhe vlerën përkatëse në lekë.

Pullat e taksave me vlera të ndryshme dallohen nga njera-tjetra nga vizatimi, ngjyra, sekreti në vizatim dhe vlera e shprehur në shifra.

Neni 5

Pullat që do të prodhohen do të jenë me vlerë nga 5 deri në 100 lekë për njësi. Jashtë këtyre vlerave nuk prodhohen pulla të taksave.

Për plotësimin e vlerës së taksës të pullës për aktet që lëshohen, mund të përdoren një ose më shumë pulla, me kusht që ato të përmbajnë vlerën sa është masa e taksës.

Pullat e taksave vendosen nga subjektet që përpilojnë aktet, në çdo kopje të dokumentit që lëshojnë.

Neni 6

Prodhimi i pullave të taksave është monopol i shtetit dhe bëhet nga subjekte të specializuara për këtë qëllim.

Neni 7

Emetimi i pullave të taksave, tirazhi i emetimit, vënia në qarkullim e çdo emisioni dhe afati i vënies së tyre në qarkullim bëhen vetëm me miratim të ministrit të Financave.

Kërkesa për prodhim të pullave të taksave përmban:

- Madhësinë e pullës (brenda përmasave të caktuara në nenin 3 të këtij ligji).
- Vizatimin përkatës.
- Vlerën e pullës.
- Sasinë.
- Subjektin prodhues.
- Sekretin në vizatim.

Kërkesa për prodhimin e pullave të taksës përbën dokument sekret.

Neni 8

Shpenzimet për prodhimin dhe shpërndarjen e pullave të taksave përballohen nga buxheti i shtetit.

Neni 9

Ministri i Financave autorizon personat fizikë e juridikë, publikë e privatë, që kanë të drejtën e shitjes së pullave të taksave.

Neni 10

Ministri i Financave miraton dhe autorizon personat përgjegjës për tërhaqjen e pullave të taksave nga prodhuesi në Ministrinë e Financave, si dhe personat përfaqësues të Ministrisë së Financave për asgjësimin e skarciteteve dhe mbetjeve të papërdorshme.

Neni 11

Mbikëqyrja dhe kontrolli për vjeljen sipas masës së taksave të parashikuara në këtë ligj dhe për derdhjen e tyre në buxhet bëhet nga punonjësit tatimorë ose persona të tjerë të parashikuar me ligje të veçanta.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në Ministrinë e Financave është e detyruar të bëjë revizione jo më pak se një herë në vit te subjektet që janë të ngarkuara me vjeljen e taksave nëpërmjet përdorimit të pullave të taksave.

Neni 12

Quhen shkelje të këtij ligji:

a) Kur aktet dhe dokumentet nuk kanë pulla me vlerë sipas lidhjes nr.1 dhe nr.2 të ligjit nr.7777, datë 22.12.1993 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”.

b) Kur subjektet pranojnë akte dhe dokumente, për të cilat nuk është aplikuar pulla e taksave.

Neni 13

Shkeljet e parashikuara në pikat “a” dhe “b” të nenit 12 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, quhen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 5 000 deri në 15 000 lekë, duke marrë taksën në vlerën e saj të plotë.

Gjobat vendosen nga kryetari i degës së tatimeve dhe taksave në rreth.

Neni 14

Ministri i Financave autorizohet të nxjerrë udhëzime për mënyrën e vjeljes së taksës nëpërmjet përdorimit të pullave.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1244, datë 9.10.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha

LISTA NR.1

AKTET DHE DOKUMENTET, PËR TË CILAT DO TË PËRDOREN PULLAT E TAKSËS

- A. Taksa për veprimet juridike që kryhen nga administrata gjyqësore:
1. Për regjistrimin e personave juridikë privatë (shtetas shqiptarë).
 2. Për lëshimin e vërtetimit se personi nuk ka pengesa ligjore për pajisjen me pasaportë për jashtë shtetit.
 3. Për lëshimin nga gjykata të çdo kopjeje vendimi e çdo dokumenti që kërkohet nga të interesuarit.
 4. Për lëshimin e vërtetimit për shqyrtim vendimi gjyqësor, penal, ose civil i formës së prerë.
 5. Për lëshimin e dëshmisë së penaltetit nga zyrat e gjendjes gjyqësore.
 6. Për legalizimin e akteve të noterisë nga Ministria e Drejtësisë.
 7. Kërkesëpadi që paraqiten në gjykatë
 - për pension ushqimor;
 - për vërtetim fakti;
 - për të gjitha paditë e tjera.
- B. Taksë për veprime që kryhen nga përmbaruesi gjyqësor:
1. Për vënien në ekzekutim të vendimeve e titujve të tjerë ekzekutivë me objekt të pavlefshëm.
 2. Për lajmërimet dhe veprimet e tjera të përmbaruesit gjyqësor.
 3. Për lëshime nga përmbaruesi gjyqësor të çdo lloj akti ose dokumenti të kërkuar nga të interesuarit.
 4. Për vënien në ekzekutim të vendimeve me objekt pensionin ushqimor.
- C. Veprime që kryhen nga zyrat noteriale:
1. Përpilimi i testamenteve.
 2. Kontrata për kalim të pronësisë.
 3. Prokura (redaktim).
 - të përgjithshme;
 - të posaçme.
 4. Akte noteriale të ndryshme (redaktim)).
 5. Vendim për dëshmi trashëgimie.
 6. Kopjim dhe vërtetim njësia me origjinalin.
 7. Vërtetim përkthimi dhe vërtetim njësia me origjinalin.
 8. Vërtetim firme në banesa ose spitale.
- D. Taksat për veprimet që kryhen në zyrat e hipotekave:
1. Për regjistrimin e vendimit, i cili përmban fitimin ose njohjen e pronësisë mbi sendet e paluajtshme, që deklaron të pavlefshme veprimet juridike për kalimin e pronësisë së regjistruar më parë.
 2. Për regjistrimin e dëshmisë së trashëgimisë në lidhje me fitimin me anë të trashëgimisë të pronësisë mbi sende të paluajtshme.
 3. Për regjistrimin e vënies së sekuestros mbi sendet e paluajtshme.
 4. Për heqjen e hipotekës.
 5. Për lëshimin e çdo dëshmie të interesuarve nga zyrat e hipotekës.

LISTA NR.2
TAKSA E AKTEVE DHE E PULLËS

1. Për lëshimin e çertifikatave të gjendjes civile.
2. Për lëshimin e pasaportave të brendshme.
3. Për regjistrimin përfundimtar të vendbanimit të ri.
4. Për marrjen e çdo akti të emërtuar ose të zhdukur të gjendjes civile, si dhe për korrigjimet e tyre.
5. Për regjistrimin e dhënies së shtetësisë.
6. Për regjistrimin e lënies së shtetësisë për çdo person madhor.
7. Për regjistrimin e vendbanimit, të ndërrimit të emrit ose mbiemrit.
8. Për çdo lidhje martese.